



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2142 Prot.

Durrës, më 22.11.2023

VENDIM
Nr. 41, datë 22.11.2023

PËR

"HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "EKONOMIA QARKULLUESE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM", NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PRANË DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE EKONOMIKE, NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës".

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.01, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit "Ekonomia Qarkulluese dhe Zhvillimi Qëndrueshëm", me 180 kredite, në ciklin e parë të studimeve Bachelor, pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike, në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Zv. Rektorët.
 - ✓ Drejtuesi i Njësise Kryesore të Fakultetit të Biznesit.
 - ✓ Drejtuesi i Njësise Bazë pranë Departamentit të Shkencave Ekonomike.
 - ✓ Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2024-2025.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksanela SOTIROFSKI

